

INDUSTRIA NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Energjetika në Republikën e Maqedonisë

Energjetika paraqet bazë për zhvillimin e çdo vendi. Prodhimi i sotëm dhe krejt jeta kulturore dhe ekonomike nuk mundet të mendohen pa energjinë si forcë lëvizëse. Ajo është baza e industrisë, ka zbatim në xehetari, komunikacion, bujqësi, hoteleri dhe në përgjithësi në ngritjen e standardit jetësor të popullsisë. Bazohet në një varg burimesh energjetike rëndësia e të cilave në kohën e caktuar dhe në shkallën e caktuar të zhvillimit të forcave prodhuese në mënyrë të ndryshme përdoret. Burimet kryesore për prodhimin e energjisë në R. e Maqedonisë janë: thëngjilli, forcat e ujit, nafta, gazi dhe druri. Prej tyre Republika e Maqedonisë disponon me thëngjillit, forcat e ujit dhe drurin, ndërsa naftë dhe gazë ende nuk janë zbuluar. Në vitet e fundit, veçmas pas krizës energjetike, veprohet edhe ndaj shfrytëzimit edhe të disa burime të energjisë që deri tani nuk shfrytëzoheshin. Ndërmjet tyre sidomos është për tu shënuar shfrytëzimi i erës, energjisë së diellit, pastaj shfrytëzimi i biomasës etj. Megjithatë energjensë kryesorë të vendit mbetën thëngjilli dhe forcat e ujit.

a). Madhësia dhe vendosja e potencialit hidroenergjikë

Uji ende paraqet burimin më të lirë të energjisë. Ajo bënë pjesë në grupin e energjisë së përtëritëshme. Ajo ju jep rëndësi të posaçme dhe e bën burim shumë të kërkuar për energjinë, megjithatë menjëherë duhet të konstatojmë se potenciale hidroenergjetik i lumenjve të Maqedonisë është mjaftë modest. Gjendja e këtyrë është pasoj e më shumë e faktorëve të shumtë kompleks të lidhur ndërmjet veti edhe atë para së gjithash të regjimit jo të volitshëm pluvimetrik dhe të reliefs. Regjimi jo i volitshëm pluvimetrik është pasoj e ndikimeve klimatike. Sasia e të reshurave është shumë e vogël, ndërsa edhe përhapja e tyre vjetore dhe territoriale nuk është i barabartë. Lumenjtë e Maqedonisë kryesisht kanë karakter rrëke dhe karakterizohen me rrjedha jo të njëtrajtshme ujore. Për shembull periudhën e verës, Bregallnica, ka ujë minimal dhe shtrati i tij të derdhja e Vardarit ndodh që të jetë edhe thatë, kurse në ujërat më të larta këtu rrjedha maksimale arrin 640 m³ /sek.

Përkundër ndikimit negativ të, të reshurave dhe rrëmbimit mbi rrjedhjen ujore dhe potencialit hidroenergjikë, relievi nëpër të cilin kalojnë lumenjtë në Republikën tonë, ofron mundësi për përmirësimin e gjendjes me forcat e ujit, sepse në pjesët e grykave të rrjedhjeve të lumenjve mundet të ndërtohen akumulime ujore me çka në masë të madhe do të largohet jo barabarësia e rrjedhjeve, kurse rritet potenciali i tyre hidroenergjetik. Pjesa më e madhe e potencialit hidroenergjetik në R.e Maqedonisë është koncentruar në lumin Vardar. Grykat e Dervenit, Taorës, Velesit dhe Demirkapisë, me lëvizje më të volitshme me akumulimin e ujërave.




Gryka e Demirkapisë. Me potencial energjetik të lumit Vardar në të prej 1300 milion KWO, ajo ende mbetet e pashfrytëzuar. Lokalitete për hidrocentrale të mundshme në lumin Vardar. Gjatë rrjedhjes së lumit Vardar nga Gryka e Taorës deri te kufiri me Greqinë në gjatësi 200 km ekzistojnë mundësi për ndërtimin e 12 hidrocentraleve. Gryka e Demirkapisë. Me potencial energjetik në lumin Vardar në të prej 1300 milion KWO, ajo ende mbetet e pashfrytëzuar.

Vlerësohet se Vardari, në krejt rrjedhën, mundet të ndahet në 15 vija. Megjithatë, deri sot asnjëra nga këto akumulacione nuk janë ndërtuar nga shkaku se lugina e Vardarit paraqet korridorin kryesor të komunikacionit në R. e Maqedonisë që e vështirëson ndërtimin, kurse edhe ajo që Vardari është ujë ndërkombëtar për shkak të, të cilit mbi të gjithëka që ndërtohet patjetër duhet të jetë në pajtim me Greqinë fqinje. Sipas energjisë së ujit dhe mundësive për shfrytëzimin e saj, potenciali i përgjithshëm teknik energjetik shfrytëzues i të gjithë lumenjve në Republikë është 6.436 milion KWO. Në to derdhje e Lumin Vardar merr pjesë me 5 193 milion KWO, në lumin Drini i Zi me 1 208 KWO dhe në lumin Strumica me 35 milion KWO.

b). Xehoret dhe prodhimi i thëngjillit

Paraqitjet e thëngjillit në R. e Maqedonisë lidhet me sedimente e liqeneve përkatësisht për fushëgropat që në të kaluarën ishin uzaurar. Ai është formuar prej moçaleve dhe vegjetacionit të bujshëm që në të kaluarën këtu ekzistonte. Sot gati në të gjitha fushëgropat është konstatuar prezenca e thëngjillit por me rezerva jo aq të mëdha.



Minierat dhe xeheroret e thëngjillit, hidrocentralet dhe termocentralet në Maqedoni

Është zbuluar prezenca dhe janë vërtetuar rezervat e thëngjillit në R. e Maqedonisë ka në basenet vijuese: **baseni i Pellagonis, baseni i Strugës, baseni i Resnjës, baseni i Mariovës, baseni i Tikveshit, baseni i Shkupit, baseni Berovës dhe baseni i Dellçevës**. Sasi e thëngjillit në to nuk është e madhe kurse edhe vetë thëngjilli bënë pesë në klasën e thëngjillit e kalorës së ulët. Megjithatë, ato prapë se prapë paraqesin potencialin e rëndësishëm energjik ngase është i mundshëm përdorimi këtij linjiti në termoelektranet për prodhimin e rrymës elektrike, në termo ngrohtoret për fi timin e energjisë së nxehtësisë, kurse pjesë dhe për përdorimin e gjerë në amvisëritë për ngrohje.

Në basenin e Pellagonis krahinës së thëngjillit kryesisht është zbuluar në pjesën jugore të fushëgropën edhe atë në rrethin e fshatrave: **Suhodoll, Gneotin dhe Zhivojno**. Rezervat e përgjithshme janë vërtetuar në rreth 420 milion tonë. Sot eksploatohet vetëm xeherorja në Suhodoll, me mihjen sipërfaqësore, kurse kapaciteti vjetor prodhues është 6 milion tonë. Krejt prodhimi përdoret për fi timin e energjisë elektrike në termoelektranet në Manastir, I,II dhe III, prodhimi vjetor i të cilave arrin 34 000 milion KWO energji elektrike. Në basenin e Kërçovës është zbuluar në më shumë vend zbulime edhe atë te fshatrat: Osllomej, Popovjani, Strogomishte, Gjubrinno dhe Arangjellë. Rezervat e përgjithshme vlerësohen në rresh 100 milion tonë, kurse eksploatohet vetëm në xeheroren e Osllomejit. Thëngjilli eksploatohet me mihje sipërfaqësore, ndërsa kapaciteti i minierës është 1.200.000 tonë në vit. Krahas minierës është ndërtuar edhe termoelektrana “Osllomej” me prodhim të 660 milion kilovat orë energji elektrike në vit. Në basenin e Strugës thëngjilli eksploatohet te fshati Piskupshtin. Megjithatë rezervat janë të vogla, arrijnë vetë në rreth 3,5 milion tonë.

Në Maqedoni thëngjill eksploatohet edhe në rrethinën e Berovës, në minierën Ratevski Shirin, në të cilin gjithashtu rezervat janë të vogla rreth 2,5 milion tonë. Minierat e thëngjillit në basenet e tjera, edhe pse janë vërtetuar rezervat e tyre nuk eksploatohet. Kështu në basenin e Pijaniçkës rezervat janë rreth 100, në të Tikveshit 140, në të Shkupit 20, Në të Mavrovës 110 milion tonë dhe tjera. Gjithsejtë në 12 vend zbulime në Republikë, janë vërtetuar rezerva prej 1 miliard tonësh. Ndaj këtyre rezervave mundet të shtohen dhe rreth 700.000 tonë treset, i cili lajmërohet në më shumë vende të Republikës. Megjithatë, për shkak të rezervave të vogla dhe kalorisë së ulët ai nuk eksploatohet. Sot thëngjill eksploatohet prej katër minierave me sasinë e përgjithshme vjetore deri më 7,5 milion tonë.

Prej emergjentëve të tjerë në Maqedoni paraqitet edhe rasa e Parafinës dhe lëndët e para nukleare. Megjithatë ato ende nuk janë hulumtuar në mënyrë të mjaftueshme dhe nuk eksploatohen. Prezenca e energjisë gjeotermale, gjithashtu, është konstatuar në më shumë zona. Megjithatë me përjashtim të së Kočanës, Gjevgjelisë dhe Strumicës, ku përdoret për ngrohjen e oranzherive, ajo ende nuk ka siguruar vend më të rëndësishme ndërmjet burimeve energjetike. Në Maqedoni ekzistojnë kushtet edhe për shfrytëzimin e energjisë diellore dhe energjisë së erës, por përfshirje më të madhe në këtë planë ende nuk ka.

c). Ndërtimi i objekteve elektroenergjetike, prodhimit dhe konsumit të energjisë së elektrike.

Zhvillimi ekonomik i Maqedonisë në të kaluarën zhvillohej në kushte specifike dhe shumë të vështira dh kishin reperkusionet e veta edhe mbi zhvillimin e elektroekonomisë. Për atë edhe ndërtimi i hidrocentraleve dhe prodhimi i rrymës elektrike te ne fillon më vonë se sa në pjesët e tjera të botës. Kështu centralja e parë elektrike në Maqedoni është ndërtuar në vitin 1909 në Shkup. Në periudhat ndërmjet dy luftërave botërore procesi i elektrifi kimi është shpejtuar mjaftë, ashtu që në vitin 1940 në territorin e vendit tonë ishin ndërtuar 18 centrale elektrike, prej të cilave 7 ishin hidrocentrale dhe 11 centrale elektrik kalorike. Ndërmjet tyre, me përjashtim të hidrocentrales së Matkës në Shkup dhe hidrocentrales në lumin Shkumbin në Tetovë, të gjitha ishin me forcë të vogël ndërtimi ekskluzivisht për plotësimin e nevojave lokale të qyteteve të veçanta.

Pas çlirimit vazhdon ndërtimi por i gjithashtu hidrocentraleve të vogla. Kështu, në periudhën prej vitit 1950 e deri më 1953 janë ndërtuar hidrocentralet “Zrnkova” në f. Zërnovci në Koçan “Sapunisa” në f. Dihove në Manastir, “Dishnica” afër Demir Kapisë dhe “Pesočani” në f. Peshçani në Debërcë. Krahas ndërtimeve të këtyre hidrocentraleve të vogla në vitin 1948 është fi lluar me ndërtimin e sistemeve të mëdha hidroenergjetike të hidrocentraleve në Mavrovë, “Vrutoku” “Vërbeni” dhe Raveni të cilët u lëshuan në përdorim në vitin 1959. Prej atëherë, dhe deri më vitin 2004 janë ndërtuar edhe disa hidrocentrale më të mëdha, si: “Gllboçica”, “Tikveshi”, “Shpilje” dhe tjera, ashtu që sot gjithsejtë janë 16 hidrocentrale më të mëdha. Përveç kësaj ekzistojnë edhe më shumë të ashtuquajtura mini hidrocentrale . prodhimi vjetorë i mundshëm i tyre i energjisë elektrike arrin 1.443 KWO, përkatësisht nga potenciali i përgjithshëm hidroenergjetik teknik i shfrytëzueshëm në R. e Maqedonisë , është shfrytëzuar 22%, kurse 78% rrjedh ende i pashfrytëzuar.

Krahas hidroelektraneve në Maqedoni ekzistojnë edhe termoelektranet. Të tilla janë: termoelektrana në “Negotin” në Negotin me fuqinë punuese të mazutit, respektivisht naftës, “Oslomej” në Kërçovë dhe “Manastiri I,II dhe III” në Pellagoni, të cilat punojnë me thëngjill.



REK "Bitola". Paraqet strumbullar i elektroekonomisë së Maqedonisë. Në vit siguron nga 3400 KWO energjisë elektrike.

Sot në r. e Maqedonisë ekzistojnë pesë termocentrale me mundësi prodhimi vjetor prej 5432 KWh. Prodhimi i përgjithshëm i hidroelektraneve dhe termoelektraneve në vitin 2000 arrin 6.797.517 milion KWh. Nga ndjekja e zhvillimit të deritanishëm e prodhimit të rrymës elektrike mundet të përfundohet se ajo është e përcjelluar me distanca të mëdha kohore në ndërtimin e kapaciteteve energjetike.

Kështu për shembull prej vitit 1970 deri më vitin 2004, kur është lëshuar në përdorim hidrocentralja e "Kozjakut" në vendin tonë nuk është ndërtuar asnjë hidrocentral.

Kjo ka pasur ndikimin e vetë mbi kontinuitetin dhe rritjen e prodhimit të energjisë elektrike.

Përkundër prodhimit të këtillë, konsumi i energjisë elektrike është rritur shumë më shpejtë, ashtu që vazhdimisht është ndier mungesë. Ajo mungesë kryesisht importohet ng shtetet fqinje.

Problemi me energji së mjaftë është zbutur me ndërtimin e rafi nerisë së naftës në Shkup, me të cilën në vit përpunohen mbi 1 milion tonë naftë. Gjendja është përmirësuar edhe me ndërtimin e gaz përcjellësit Sofje-Shkup.